



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:015315
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05387305

CML.nr.1/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Millena Gjeriq, kryetare, Beshir Islami dhe Mr.sc. Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi” SH.A. me seli në P., Rruga “....”, p.nr., kundër debitorit H. K. nga P., Rruga “....”, p.nr., për pagesën e borxhit në vlerë prej 695.65 €, përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLC.nr.125/2023 datë 03.01.2024, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, C.A.P. 990/2023, datë 29.09.2023, në seancën e mbajtur më 28.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet kërkesa e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, për mbrojtje të ligjshmërisë, prishet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, C.A.P. 990/2023, datë 29.09.2023, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Përmbaruesi Privat F. B. si organ përmbarues, me urdhrin P.nr..... të datës 30.03.2018, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka caktuar përmbarimin në bazë të

dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit të verifikuar nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të bartjes së mbeturinave, të lëshuar nga kreditori Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” SH.A., me seli në P., për periudhën nga data 28.02.2005 deri më datën 31.12.2017, e cila sipas nenit 21 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje referuar si: LPP) paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ndërsa në bazë të nenit 29 paragrafi 1, pika 1.2 të këtij ligjit paraqet dokument të besueshëm.

Me aktvendimin P.nr.462/18, të datës 12.05.2021, Gjykata Themelore në Prishtinë, Divizioni civil, ka vendosur që refuzohet i pabazuar prapësimi i debitorit H. K. nga P., i ushtruar ndaj urdhrorit përmbartimor P.nr...., i datës 30.03.2018, të lëshuar nga përmbartuesi privat F. B., si organ përmbartues.

Kundër këtij aktvendimi pas afatit ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që të aprovohet në tërësi ankesa e kreditorit, aktvendimin e ankimuar ta anuloj për pikën I dhe çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose ta ndryshojë aktvendimin e shkallës së parë dhe ta refuzojë si të pathemeltë prapësimin e debitorit me arsyetimin se borxhi është parashkruar.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, C.A.P. 990/2023, datë 29.09.2023, hedhet poshtë si e pas afatshme ankesa e debitorit H. K. nga P. me adresë, rruga "...." p.nr. e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.462/2018 i datës 20.02.2023

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës, ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 247 par. 1 pika (a) lidhur me nenin 186 par. 2, pika (i) dhe (n) të LPK –ës, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovon kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe aktvendimin e cekur ta prishë, ashtu që çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rishqyrtim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 251 lidhur me nenin 230 të LPK -ës ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në seancën në të cilën është marrë aktvendimi sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, në pajtim me nenin 250 të LPK -ës, Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës dhe debitori janë njoftuar me rregull por nuk kanë qenë të pranishëm, ndërsa ka marrë pjesë përfaqësuesja e kreditorit M. V. me autorizim.

Nga shkresat e lëndës konstatohet debitorit i është dërguar nga një kopje e aktvendimit PPP.nr.462/2018 i datës 20.02.2023 më 27.02.2023 e që vërtetohet nga fletkthesa. Sipas Gjykatës së Apelit nga momenti i pranimit të aktvendimit më datë 27.02.2023, e deri në dorëzimin e ankesës në Gjykatë më datë 08.03.2023, e cila bazohet në vulën e pranimit të gjykatës, kanë kaluar 9 ditë, ndërsa afati për paraqitjen e ankesës është 7 ditë. Si datë e fundit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 06.03.2023, që do të thotë ankesa e kreditorit është paraqitur pas afatit të paraparë ligjor, pra është dorëzuar 2 ditë pas afatit ligjor, për të cilën arsye Gjykata e Apelit me aktvendimin e vet e ka hedh si të pas afatëshme ankesën e kreditorit.

Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund të pranojë një konkludim të tillë të gjykatës së shkallës së dytë, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktvendimit të goditur. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e kundërshtuar e ka marrë në bazë të shkeljes së dispozitës së nenit 247 par. 1 pika (a) lidhur me nenin 182 par. 2, pika (i) dhe (n) të LPK –ës, ngase, gjykata e shkallës së dytë afatshmërinë e ankesës e ka vërtetuar në bazë të vulës së pranimit të ankesës në gjykatë, ndërsa kreditori gjykatës i ka prezantuar provën se ankesën kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë e ka dorëzuar me postë rekomande më datë 25.05.2018.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, ka pranuar propozimin e debitorit për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër aktvendimit, të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, .A.P. 990/2023, datë 29.09.2023. Pas shqyrtimit të pretendimeve të kreditorit

Kompania Rajonale Ujësjetësi "Prishtinë" sh.a. ka gjetur se Gjykata e Apelit në Prishtinë, ka gabuar në llogaritjen e afatit, respektivisht nenin, 196 të Ligjit për Procedurën Kontestimore që nënkupton se ka bërë shkelje edhe nga neni 77 par.2 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore kur me aktvendim e hedh ankesën si të pasafatshme.

Zyra e Prokurorit të Shtetit për të vërtetuar datën e saktë të dorëzimit të ankesës në postë, i ka bashkangjitur kërkesës dëshmitë origjinale të dëftesës së dorëzimit nga debitori, në Postën e Kosovës, përkatësisht në zyrën postare Prishtina 10010, e vulosur më datën 06.03.2023 dhe e nënshkruar nga punonjësi i postës së bashku me fletë pagesën për ankesën e dorëzuar. Me numër të pranimiit

Andaj, Gjykata Supreme e Kosovës e aprovoi Kërkesën për faktin se ankesa është e paraqitur brenda afatit prej 7 ditëve dhe Gjykata e Apelit ka llogaritur gabimisht afatin, respektivisht gabimisht ka zbatuar nenin, 196 të Ligjit për Procedurën Kontestimore që nënkupton se ka bërë shkelje edhe nga neni 77 par.2 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, prandaj kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të aprovohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rivendosje, për të vendosur lidhur me ankesën pasi që e njëjta është e afatshme.

Gjykata e shkallës së dytë është e detyruar që në rishqyrtim t'i mënjanojë të metat e cekura më lartë, të vlerësoi bazueshmërinë e ankesës së paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, konform provave që gjinden në shkresat e lëndës, e pastaj të marrë një vendim të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 251 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CML.nr.1/2024, datë 28.02.2024

Kryetarja e kolegjit,

Millena Gjeriq